

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: SHERBIMI I MIREMBAJTJES SE GJELBERIMIT

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar date 23.12.2020, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar Autoriteti Kontraktor Bashkia Kavajë ka vendosur që procedura e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar” me objekt: “Sherbimi i mirembajtjes se gjelberimit” të mos kryhet e ndarë në lote, nisur nga natyra e shërbimit dhe territori i kufizuar ku do të kryhet gjelberimi konkretisht në territorin e Bashkisë Kavaje. Ky shërbim është lehtësisht i menaxhueshëm dhe i realizueshëm duke bërë të mundur që AK të zgjedhi këtë procedurë pa e ndarë me lote.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

CPV 77211500-7 Shërbime të mirëmbajtjes së pemëve

VLERA E FONDIT LIMIT: 233,879,642 (dyqind e tridhjetë e tre milion e teteqind e shtatëdhjetë e nente mijë e gjashtëqind e dyzet e dy) leke pa tvsh ose **2,428,909** (dy milion e katërqind e njëzet e tete mijë e nentëqind e nente) Euro pa TVSH

Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë më datë 24.02.2026 është 96.29 lekë (perditesimi i fundit)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kavaje ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të viteve 2022, 2023 dhe 2024, lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit. Në zbatim të nenit 43, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar mësipër. Kur oferta

paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77 pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2 gërma "a", të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Bazuar në nenin 43 pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" kjo kërkesa për konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor. Duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, mundësinë e pjesëmarrjes nga operatorët ekonomikë dhe balancimin e raportit të kërkesës.

Kërkesa për paraqitjen e xhiros së viteve financiare 2022, 2023 dhe 2024, nuk i kufizon operatorët ekonomik vetëm në vite që mund të jenë jo të sukseshme financiarisht, por me kohështirje tre vjetecare. Vlera e xhiros së kërkuar në masë jo më e vogël se vlera e fondit limit shkon përshat me vlerën e fondit limit dhe afatin e realizimit të kontratës. Konkretisht niveli i aktivitetit të shoqërisë është në masë financiare ekuivalent me vlerën e mundshme të kontratës objekt prokurimi.

2.2.2 Kopje të certifikuara të bilanceve të viteve 2022, 2023 dhe 2024 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në nenin 43 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe nenin 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar"

2.2.3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Për të përmbushur kërkesën e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 26 pika 6, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor dokumentacionin provues i përcaktuar mësipër përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. Referuar nenin 26 pika 7, kanë për detyrë të japin sqarime dhe dokumente mbështetëse mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar, në cdo rast, me kërkesë të Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave ekonomike, në një vlerë jo më të vogël se 25% të vlerës së përllogaritur të fondit limit. Për të provuar përvojën e mëparshme, duhet që:

1. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten kontrata ose kontratat e shërbimit, vërtetimi/et e realizimit me sukses të lëshuar për të njëjtën kontratë dhe faturën/faturat tatimore të shitjes (situacionet), të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara..
2. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rast se kontratat e ngjashme janë lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqiten edhe kontratat e bashkëpunimit midis tyre.

Në rast se kontrata/kontratat e ngjashme janë lidhur në cilësinë e nënkontraktorit, operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin gjithashtu kontratën/kontratat bazë të lidhur me Autoritetin Kontraktor, në të cilën të jenë përfshirë dhe detyrimet e marra përsipër për t'u realizuar nga nënkontraktori.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet referuar nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, mundësinë e pjesëmarrjes nga operatorët ekonomikë dhe balancimin e raportit të kërkesës për punë të ngjashme me vlerën 5-vjecare të fondit limit.

2.3.2. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, të kategorisë NP-12 (punime të inxhinierisë së mjedisit).

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

NP 12 - Punime të inxhinierisë mjedisore. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimi të kompaktësimi të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për

aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të bazeneve hidrografike, eliminimin e prishjessë ekulibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte.

Shërbimet e mirëmbajtjes së gjelbërimit kanë impakt mjedisor në të gjithë territorin e Bashkisë Kavajë, është qëllimi kryesor dhe objekti i realizimit të këtij shërbimi. Bazuar në ligji nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" (i ndryshuar), si dhe nenit 39, pika 7, gërma "c", të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" është e domosdoshme që shoqëritë të jenë të pajisura me licencat, certifikatat dhe stafin e specializuar për implementimin e kërkesave të akteve ligjore gjatë realizimit të këtij shërbimi.

2.3.3. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të kenë stafin e tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit

1. Për të provuar këtë kapacitetet, operatorët ekonomikë ofertues duhet të përcaktojnë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të shërbimit shoqëruar me kontratë të vlefshme pune, librezë pune dhe CV, I cili duhet të jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik gjatë periudhës Dhjetor 2025-Shkurt 2026.
2. Për të provuar këtë kapacitetet, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune, diplomë, librezë pune, CV dhe certifikatë të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial / ekuivalente për 1 (një) Inxhinier Agronom/Pyjesh/Agrar, 1 (një) Inxhinier Mjedisi dhe 1 (një) Arkitekt Peisazhi. Stafi i mësipërm, duhet të jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik gjatë periudhës Dhjetor 2025-Shkurt 2026.
3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar /certifikuar shqiptar ose i huaj për 1 (një) ekspert që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të shërbimeve, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".
4. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar /certifikuar shqiptar ose i huaj për 1 (një) ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".
5. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe certifikatë të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial/ekuivalente dhe të vlefshme për 3(tre) specialist krasites pemesh, 3(tre) specialist kosites siperfaqe e gjelbert, 2 (dy) luleshtar, 2 (dy) karpentier dhe 2 (dy) bojaxhinj . Stafi i mësipërm, duhet të jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik të paktën gjatë periudhës Dhjetor 2025-Shkurt 2026
6. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe leje drejtimi përkatëse për 2 (dy) manovrator dhe 3(tre) shoferë të kategorisë përkatëse. Stafi i mësipërm, duhet të jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik gjatë periudhës Dhjetor 2025-Shkurt 2026

Për të përmbushur kërkesën e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 26 pika 6, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë

Autoritetit Kontraktor dokumentacionin provues i përcaktuar mesipër përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. Referuar nenit 26 pika 7, kanë për detyrë të japin sqarime dhe dokumente mbështetëse mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar, në cdo rast, me kërkesë të Autoritetit Kontraktor.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

- Inxhinier Agronom/Pyjesh/Agrar është përgjegjës për realizimin e shërbimit të mirëmbajtjes së gjelbërimit. Ai përcakton me saktësi kohën, mënyrën dhe materialet e nevojshme për realizimin e secilit prej zërave të preventivit me të njëjtin objekt.
- Inxhinier Mjedisit është përgjegjës për zbatimin e saktë të shërbimeve konformë legjisllacionit në fuqi dhe normave mjedisore përkatëse. Gjithashtu kërkesa për inxhinier mjedisit është në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës NP 12.
- Arkitekti i Peisazhit është përgjegjës për planifikimin dhe vendndodhjet e mbjelljeve dhe llojet (ngjyrën, lartësinë e bimës, volumin etj) të luleve, shkurreve dhe pemëve brenda këtyre mjedisëve, oborre, lulishte, rrugë, parqe etj..

Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për 1 (një) ekspert që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve dhe 1 (një) ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.“.

Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Eksperti që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve duhet të jete në kantier për minimizimin e aksidentëve në punë.

Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave duhet të jete në kantier në rast aksidentesh në punë, për të dhënë ndihmë e parë.

Kërkesa për 3(tre) specialist krasites pemesh lidhet me zerrat e preventivit për krasitje druresh dekorativ si palma apo drure deri në 20 vjet dhe krasitje bordurash të gjelbërta

3(tre) specialist kosites sipërfaqe të gjelbërta lidhet me zerrat e preventivit të pikës I “MIRËMBAJTJE E SIPËRFAQEVE TË GJELBËRTA”

2 (dy) luleshtar lidhet me zerrat e preventivit të pikës IV RINOVIM I SIPËRFAQEVE TË GJELBËRTA, V RINOVIM BORDURË TË GJELBËRTA (10 %) dhe pikës VI MBJELLJE E SIPËRFAQEVE ME LULE SEZONALE.

Kërkesa për 2 (dy) karpentier dhe 2 (dy) bojaxhinj është nevojshme për realizimin e shërbimeve të riparimit stolash të dëmtuar dhe pastrimit dhe lyejës stolash.

Kërkesa për 2 (dy) manovrator dhe 3(tre) shoferë lidhet ngushtesisht me mjetet që kerkohen për kryerjen e shërbimeve.

2.3.4. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- a. Vërtetim për fuqinë mesatare punëtore për mesatarisht 35 (tridhjetë e pesë) punonjës për periudhën Dhjetor 2025-Shkurt 2026, i lëshuar nga Administrata Tatimore.
- b. Listëpagesat, sipas formatit të miratuar nga Administrata Tatimore, për periudhën Dhjetor 2025-Shkurt 2026.

Për të përmbushur kërkesën e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 26 pika 6, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor dokumentacionin provues i përcaktuar mesipër përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. Referuar nenit 26 pika 7, kanë për detyrë të japin sqarime dhe dokumente mbështetëse mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar, në cdo rast, me kërkesë të Autoritetit Kontraktor.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Nr.	EMËRTIMI I SHËRBIMEVE	Njësia	Frekuenca (here/vit)	Sasia	Sasia / vit	Orë pune / njësi	Orë pune në total
		1	2	3	4=2*3	5	6= 4 x 5
I	MIRËMBAJTJE E SIPËRFAQEVE TE GJELBËRTA						
1	Pastrim me krehër i barit	m2	12	51,534	618,408	0.004	2,474
2	Pastrim I sipërfaqeve të barit me punëtorë me fshesa	m2	24	51,534	1,236,816	0.004	4,947
3	Kositje bari me makinë korrëse (90% e sip)	m2	12	46,381	556,567	0.005	2,783
4	Kositje bari me kosë motorrike (10% e sip)	m2	12	5,153	61,841	0.005	309
5	Vaditje tapet bari	m2	12	51,534	618,408	0.003	1,855
6	Plehërim i tapetit të barit me pleh kimik	m2	4	51,534	206,136	0.003	618
7	Kositje bari me kosë motorrike në sipërfaqet e varrezave	m2	12	43,000	516,000	0.005	2,580
SHUMA I							15,567
II	MIRËMBAJTJE E DRURËVE DEKORATIV						
1	Punim me bel, 20 - 25cm thellësi	m2	1	4,544	4,544	0.760	3,453
2	Prashitje (frezim, shkriftim) 10 - 12cm thellësi dhe plehërim	m2	2	4,544	9,088	0.380	3,453
3	Krasitje drurësh deri 20 vjet	copë	1	11,023	11,023	0.100	1,102

4	Krasitje palmash	copë	2	338	676	0.100	68
5	Punim rreth kurorës dhe dhënie formë	copë	2	11,023	22,046	0.150	3,307
6	Vaditje dru dekorativ	copë	6	11,361	68,166	0.050	3,408
7	Spërkatje me insekticide dru dekorativ	copë	2	11,361	22,722	0.040	909
SHUMA 2							15,701
III	MIRËMBAJTJE BORDURË E GJELBËR						
1	Punim me bel, 20 - 25cm thellësi	m2	1	2,709	2,709	0.760	2,059
2	Prashitje (frezim, shkretim) 10 - 12cm thellësi dhe plehërim	m2	3	2,709	8,127	0.380	3,088
3	Krasitje bordurë e gjelbër dhe dhënie formë	ml	6	5,161	30,966	0.100	3,097
4	Vaditje bordurë e gjelbër	m2	12	3,612	43,344	0.005	217
5	Spërkatje me insekticide bordurë e gjelbër	ml	2	5,161	10,322	0.040	413
						SHUMA 3	8,873
IV	RINOVIM I SIPËRFAQEVE TË GJELBËRTA						
1	Punim I parë me bel (25-30 cm)	m2	1	5,153	5,153	0.760	3,916
2	Punim I dytë me bel (15- 20 cm)	m2	1	5,153	5,153	0.570	2,937
3	Shkrimtim dhe thyerje plisash	m2	1	5,153	5,153	0.020	103
4	Sheshim dheu pas punimit (para nivelimit)	m2	1	5,153	5,153	0.062	317
5	Shpërndarje plehu organik	m2	1	5,153	5,153	0.008	41
6	Nivelim, mbledhje mbeturinash	m2	1	5,153	5,153	0.018	92
7	Mbjellje e farës së barit	m2	1	5,153	5,153	0.032	165
8	Rulim dhe ngjeshje pas mbjelljes	m2	1	5,153	5,153	0.020	103
9	Vaditje e sipërfaqes së barit të rinovuar	m2	3	5,153	15,459	0.008	124
						SHUMA 4	7,798
V	RINOVIM BORDURË E GJELBËR (10 %)						
1	Germim dheu me ekskavator, ne kanale gjerësi 15x20cm, toke zakonshme, me shkarkim ne toke	m3	1	9	9	0.094	1
2	Shpërndarje plehu organik	m2	1	361	361	0.008	3
3	F.V. shkurre dekorative Leandra	copë	1	2,000	2,000	0.100	200
4	F.V. Shkurre dekorative Trendafil	copë	1	500	500	0.100	50
5	Vaditje bordurë e gjelbër e rinovuar	m2	3	361	1,083	0.008	9
						SHUMA V	262
VI	MBJELLJE E SIPËRFAQEVE ME LULE SEZONALE						
1	F.V. Lule dekorative sezonale e celur	copë	3	1,000	3,000	0.100	300
2	Vaditje lule dekorative sezonale e celur	m2	6	3,000	18,000	0.008	144
3	Shkulje rrenjesh dhe nxjerrje jashte parcele pas tharjes	m3	1	5,000	5,000	0.200	1,000
						SHUMA VI	1,444

VI I	MIRËMBAJTJE TROTUARE DHE SHESHE						
1	Skarifikim bari me lopate	m2	6	23,405	140,430	0.060	8,426
2	Transport mbeturinash me karroce dore	m3	6	10	60	6.300	378
3	Riparim stolash të dëmtuar	copë	1	100	100	0.500	50
4	Pastrim dhe lyerje stolash	m2	1	134	134	8.800	1,183
SHUMA VII							10,037
Totali I oreve te punes ne vit (Shuma 1-7)							59,682

Punetori = ore ne totali : 8 ore pune ne dite : 260 dite pune ne vit	27
Staf teknik	3
Shofer	5
Total	35

2.3.5. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën. Konkretisht 1 (një) vinc me kosh me krahë $\geq 10\text{m}$ të lartë; 1 (një) autovinc; 2 (dy) kamionçina me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton ; 2 (dy) autobot uji me kapacitet 10 m3 per vaditje; 3 (tre) makina korrëse; 5 (pesë) kosë motorrike; 2 (dy) krasitëse ligustrash $\pm 45\text{cm}$; 5 (pesë) shkallë dyshe për punime lartesi 3-5 m dhe 5 (pesë) pompë për spërkatje.

Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike, operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë leje e qarkullimit, çertifikata e pronësisë, çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore, leja e transportit (vetëm për kamionët dhe kamionçinat), foto perkatëse ballore dhe anesore.

Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike që merren me qira, operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë kontratë noteriale e qirasë e vlefshme gjatë gjithë afatit të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Bashkangjitur kontratës së qirase duhet të jenë leja e qarkullimit, çertifikata e pronësisë, çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore, leja e transportit (vetëm për kamionët dhe kamionçinat), foto perkatëse ballore dhe anesore..

Për mjetet dhe pajisjet që nuk pajisen me leje qarkullimi operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë dokument te vlefshëm që vërteton pronësinë apo marrjen me qira të tij dhe foto perkatëse.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të përmbushur kërkesën e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public” neni 26 pika 6, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor dokumentacionin provues i përcaktuar mesipër përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. Referuar nenit 26 pika 7, kanë për detyrë të japin sqarime dhe dokumente mbështetëse mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar, në cdo rast, me kërkesë të Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 *"Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim"*.

Konkretisht:

- 1 (një) vinc me kosh me krahë $\geq 10\text{m}$ të lartë, parashikuar në zërat e shërbimeve në preventiv Krasitje drurësh deri 20 vjet; Krasitje palmash; Punim rreth kurorës dhe dhënie formë.
- 1 (një) autovinc parashikuar për transport dhe shkarkim materialeve etj.
- 2 (dy) kamionçina me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton parashikuar në zërat e shërbimeve në preventiv transport materialeve dhe mbeturinash pas kryerjes së shërmimeve si kositje bari, krasitje drurësh deri 20 vjet; Krasitje palmash; Punim rreth kurorës dhe dhënie formë; Krasitje bordurë e gjelbër dhe dhënie formë; F.V. Lule dekorative sezonale e celur etj.
- 2 (dy) autobot uji me kapacitet 10 m^3 per vaditje parashikuar në zërat e shërbimeve në preventiv Vaditje tapet bari; Vaditje dru dekorativ; Vaditje bordurë e gjelbër; Vaditje e sipërfaqes së barit të rinovuar; Vaditje lule dekorative sezonale e celur.
- 3 (tre) makina korrëse; 5 (pesë) kosë motorrike; 2 (dy) krasitëse ligustrash $\pm 45\text{cm}$; parashikuar në zërat e shërbimeve në preventiv Kositje bari me makinë korrëse (90% e sip); Kositje bari me kosë motorrike (10% e sip); Kositje bari me kosë motorrike në sipërfaqet e varrezave; Krasitje bordurë e gjelbër dhe dhënie formë
- 5 (pesë) shkallë dyshe për punime lartesi 3-5 m parashikuar në zërat e shërbimeve në preventiv krasitje drurësh deri 20 vjet; Krasitje palmash; Punim rreth kurorës dhe dhënie formë.
- 5 (pesë) pompë për spërkatje parashikuar në zërat e shërbimeve në preventiv Spërkatje me insekticide dru dekorativ; Spërkatje me insekticide bordurë e gjelbër

2.3.6. Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

1. Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH/DIN/EN/UNI **ISO 9001-2015** “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” e përditësuar, e vlefshme/ekuivalente.
2. Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH/DIN/EN/UNI **ISO 14001-2015** ”Sisteme të menaxhimit të mjedisit” e përditësuar, e vlefshme/ekuivalente.
3. Certifikatën SSH/ EN/UNI **ISO 45001:2018/45001-2023** ”Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” e përditësuar, e vlefshme/ekuivalent.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim opera torësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH/DIN/EN/UNI mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis të projektit si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001:2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001:2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zerat e parashikuara sipas Preventivit.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

2.3.7. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të kenë në dispozicion apo që mund t’i vihet në dispozicion për të përmbushur kontratën, ambient me sipërfaqe jo më e vogël se 1000 m² në territorin e Bashkisë Kavajë, e cila do të shërbejë për parkimin e mjeteve dhe nevoja të tjera. Për të provuar këtë duhet të paraqitet dokument i vlefshëm që vërteton pronësinë. Në rastin kur ambjenti merret me qira duhet të paraqitet kontratë e vlefshme qiraje dhe dokument i vlefshëm që vërteton pronësinë e qiradhënësit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku konkretisht citohet: AK, *përveç kërkesave të*

parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Referuar numrit të madh të makinerive dhe mjeteve të punës që duhet për realizimin e shërbimit të gjelberimit, i cili është shërbim ditor lind nevoja për vendin e parkimit për të shmangur dhe rendese në rrugët e Bashkisë Kavaje.

Operatorët ekonomikë, bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, paraqesin si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe nenit 26 të VKM 285 dt.19.05.2021.

Për të përmbushur kërkesën e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public” neni 26 pika 6, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor dokumentacionin provues i përcaktuar mësipër përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. Referuar nenit 26 pika 7, kanë për detyrë të japin sqarime dhe dokumente mbështetëse mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar, në çdo rast, me kërkesë të Autoritetit Kontraktor.

Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe “ekuivalentin” e tij/tyre.

Në të gjitha rastet kur AK në specifikimet teknike i është referuar vetëm standarteve europiane, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe paraqitjen e standarteve SSH/DIN/EN/UNI/ISO.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.